



Nr. 04/ 1274 /2016

DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA

RAPORT FINANCIAR PËR PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2015

HANI I ELEZIT, Shkurt 2016

Raport financiar për periudhën janar-dhjetor 2015

Raporti financiar për periudhën janar-dhjetor 2015, është përgatitur në bazë të dispozitave të nenit 45, paragrafët 45.2 dhe 45.4 dhe nenit 46 paragrafët 46.1 dhe 46.2 të Ligjit Nr. 03/L-048 “Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi” dhe statutin e komunës Hani i Elezit.

Raporti financiar për periudhën janar-dhjetor 2015 ka për qëllim të informimit objektiv lidhur me ecurinë dhe treguesit relevant rreth përmbushjes së planit, grumbullimit të mjeteve sipas burimeve, përmbushjes së obligimeve të planifikuara sipas planprogrameve, dinamikës së mjeteve të shpenzuara sipas natyrës së shpenzimeve dhe kategorive të përcaktuara buxhetore, rrjedhën e parasë si dhe treguesit tjerë që kanë treguar në rezultatet e përgjithshme për këtë periudhë vjetore.

Ecuria e përgjithshme e këtyre treguesëve do të prezantohet për 12 programe buxhetore:

1. Zyra e Kryetarit,
2. Administrata e Përgjithshme,
3. Zyra e Kuvendit Komunal,
4. Buxhet dhe Financa,
5. Shërbimet Publike dhe Emergjencë,
6. Zyra Komunale për Komunitete,
7. Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural,
8. Zhvillimi Ekonomik,
9. Planifikim Urban, Kadastri dhe M.Mjedisit,
10. Shëndetësia
11. Shërbimet Sociale
12. Arsimi dhe Kultura.

BUXHETI KOMUNAL 2015

Buxheti i komunës së Hanit të Elezit i ndarë sipas Ligjit të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015 me Nr. 05/L-001 është 2,051,844.00 Euro, ndërsa ai përfundimtar është 2,204,662.56 Euro (duke përfshirë bartjen e të hyrave vetanake në shumë prej 44,242.55 € mjete shtesë me rishikim të buxhetit në shumë prej 100,000.00 € nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe në fund për mbulesë të kategorisë paga dhe mëditje në shumë prej 8,576.01 €).

Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim: Paga dhe mëditje 1,368,292.81 € mallra dhe shërbime 267,500.00 € shpenzime komunale 48,138.65 € subvencione dhe transfere 50,082.10 € dhe shpenzime kapitale 470,649.00 € Pjesën më të madhe të këtij buxheti e kanë pagat dhe mëditjet me 62.06%, shpenzime kapitale me 21.35%, mallrat dhe shërbimet me 12.13%, subvencionet dhe transferet me 2.18% dhe shpenzimet komunale me 2.27%.

Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i realizimit të përgjithshëm për këtë periudhë janardhjetor 2015 është në shumë prej 2,040,413.41 € apo 92.55 %.

Prej tyre për paga dhe mëditje janë shpenzuar 1,366,431.86 € (99.86%), në mallra dhe shërbime 264,565.53 € (98.90%), në shpenzime komunale 48,060.96 € (99.84%), në subvencione dhe transfere 47,639.60 € (95.12%) dhe në shpenzime kapitale 313,715.46 € (66.66%).

Tabela 1. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitin 2015 dhe 2014 - krahasimi

KESH	Buxheti 2015	Realizimi	%	Buxheti 2014	Realizimi	%
Paga dhe mëditje	1,368,292.81	1,366,431.86	99.86	1,245,046.05	1,239,194.15	99.53
Mallra dhe shërbime	267,500.00	264,565.53	98.90	174,296.38	147,697.42	84.74
Shpenzime komunale	48,138.65	48,060.96	99.84	37,500.00	35,918.12	95.78
Subvencione dhe trans.	50,082.10	47,639.60	95.12	37,245.07	37,162.97	99.78
Shpenzime kapitale	470,649.00	313,715.46	66.66	531,093.68	420,696.34	79.21
TOTALI	2,204,662.56	2,040,413.41	92.55	2,025,181.18	1,880,669.00	92.86

Komente dhe shpjegime:

- Pagat dhe mëditjet për vitin 2015 janë më të larta për 10.27% (127,237.71 €) se në periudhën e njëjtë të vitit 2014;
- Mallrat dhe shërbimet për vitin 2015 janë më të larta për 79.13% (116,868.11 €) se në periudhën e njëjtë të vitit 2014;
- Pagesat për shpenzime komunale për vitin 2015 janë më të larta për 33.81% (12,142.84 €) se në periudhën e njëjtë të vitit 2014;
- Subvencionet dhe transferet krahasuar me vitin 2015 janë më të larta për 28.19% (10,476.63 €) se në periudhën e njëjtë të vitit 2014;
- Pagesat për investime kapitale gjatë për vitin 2015 janë më të ulta për -25.43% (-106,980.88 €) se në periudhën e njëjtë të vitit 2014;
- Gjithsej shpenzimi për vitin 2015 është më i lartë për 8.49% (159,744.41 €) se në periudhën e njëjtë të vitit 2014.

Tabela 2. Raporti i ekzekutimit të buxhetit 2015 sipas drejtorive

PROGRAMET BUXHETORE	Buxheti 2015	Mjetet e alokuara	Mjetet e paalokuara	Mjetet e shpenzuara	Mjetet e zotuarra dhe te lira	% e shpenzuar
	1	2	3	4	5	6
ZYRA E KRYETARIT	200,479.99	200,479.99	-	198,827.64	1,652.35	99.18
ADMINISTRATA E PËRGJITHSHME	195,045.49	195,045.49	-	194,666.70	378.79	99.81
ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL	58,257.45	58,257.45	-	58,057.45	200.00	99.66
BUXHET DHE FINANCA	52,403.53	52,403.53	-	52,403.53	-	100.00
SHËRBIMET PUBLIKE	99,797.92	99,117.10	680.82	99,075.06	42.04	99.28
ZYRA E KOMUNITETEVE	4,253.12	4,253.12	-	4,253.12	-	100.00
BIJQËSIA DHE PYLLTARIA	43,246.10	43,246.10	-	41,503.56	1,742.54	95.97
ZHVILLIMI EKONOMIK	20,353.78	20,353.78	-	20,353.78	-	100.00
PLANIFIKIMI URBAN DHE MJEDISI	353,809.98	311,996.05	41,813.93	201,908.40	110,087.65	57.07
SHËNDETËSIA	256,817.68	255,277.68	1,540.00	255,275.98	1.70	99.40
SHËRBIMET SOCIALE	20,850.72	20,745.22	105.50	20,745.22	-	99.49
ARSIMI DHE KULTURA	899,346.80	894,026.75	5,320.05	893,342.97	683.78	99.33
TOTALI	2,204,662.56	2,155,202.26	49,460.30	2,040,413.41	114,788.85	92.55

Në këtë tabelë kemi paraqitur buxhetin sipas drejtorive për mjetet e shpenzuara dhe shprehur në %.

Tabela 3. Raporti i ekzekutimit të buxhetit 2015 me donacione

	2015				2014
	Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (Ndarja)	Realizimi	Varianca	Realizimi
	A	B	C	D=C-B	0
Hyrja e parasë së gatshme					
Të hyrat vetanake	256,258.00	256,258.00	223,521.25	(32,736.75)	277,232.12
Donacionet		63,936.95	53,953.80	(9,983.15)	21,401.84
Gjithsejt Pranimet	256,258.00	320,195.00	277,475.00	(4,272.00)	298,633.96
Daljet e parasë së gatshme					
Paga dhe roga	1,358,378.00	1,368,292.81	1,366,431.86	(1,860.95)	1,239,194.15
Mallra dhe shërbime	149,000.00	267,500.00	264,565.53	(2,934.47)	147,697.42
Shërbime komunale	37,817.00	48,138.65	48,060.96	(77.69)	35,918.12
Transfere dhe subvencione	50,000.00	50,082.10	47,639.60	(2,442.50)	37,162.97
Shpenzime kapitale	456,649.00	534,585.95	367,669.26	(166,916.69)	442,098.18
Gjithsejt pagesat e bëra	2,051,844.00	2,268,599.51	2,094,367.21	(174,232.30)	1,902,070.84

Tabela 4. Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme me donacione

		2015			2014
		Buxheti final	Realizimi	%	Realizimi
BURIMET E FONDEVE					
Granti qeveritar - 10	1	1,904,161.96	1,901,743.27	99.87	1,620,495.30
Të hyrat vetanake - 21	2	256,258.05	94,536.00	36.89	233,030.07
Të hyrat vetanake të bartura - 22	3	44,242.55	44,134.14	99.75	27,143.63
Grantet e donatorëve	4	63,936.95	53,953.80	84.39	21,401.84
Gjithsejt		2,268,599.51	2,094,367.21	92.32	1,902,070.84

Shpjegim:

- Sipas **grantit qeveritar** (përfshirë grantin e përgjithshëm, të arsimit dhe të shëndetësisë, shpenzimi për periudhën janar-dhjetor 2015 është në shumë 1,901,743.27 Euro apo 99.87%.
- Sipas **të hyrave vetanake – 21** shpenzimi është në shumë prej 94,536.00 Euro apo 36.89%.
- Sipas **të hyrave vetanake të bartura – 22** shpenzimi është në shumë prej 44,134.14 Euro apo 99.75%.
- Sipas **granteve të donatorëve** shpenzimi është në shumë prej 53,953.80 Euro apo 84.39%.
- Pra, në total shpenzimi nga financimi qeveritar, të hyrat vetanake dhe donacionet është në shumë prej 2,094,367.21 Euro apo 92.32% e planifikimit vjetor.

Tabela 5. Ndarjet e fondit të përgjithshëm

	2015	2014
	BKK	BKK
Klasifikimi ekonomik	€	€
Paga dhe rroga	1,356,954.00	1,235,046.05
Mallra dhe shërbimet	231,173.50	124,430.50
Shërbime komunale	40,239.00	30,919.17
Subvencione dhe transfere	15,000.00	17,000.00
Shpenzime kapitale	258,376.50	213,099.58
Gjithsejt	1,901,743.00	1,620,495.30

Tabela 6. Të hyrat vetanake

	2015	2014
	THV	THV
Klasifikimi ekonomik	€	€
Paga dhe rroga	9,477.90	4,148.10
Mallra dhe shërbimet	33,392.03	23,266.92
Shërbime komunale	7,821.65	4,998.95
Subvencione dhe transfere	32,639.60	20,162.97
Shpenzime kapitale	55,338.96	207,596.76
Gjithsejt	138,670.14	260,173.70

Tabela 7. Grantet e përcaktuara të donatorëve

	2015	2014
Klasifikimi ekonomik	€	€
Paga dhe rroga	-	-
Mallra dhe shërbimet	-	-
Shërbime komunale	-	-
Subvencione dhe transfere	-	-
Shpenzime kapitale	53,953.80	21,401.84
Gjithsejt	53,953.80	21,401.84

Donacion nga UN-HABITAT për projektin “Shtrimi me kubëza betoni nga Shf. Ilaz Thaçi deri te Dheu i Bardhë” në shumë prej 5,350.24 EUR (projekt i vitit 2014).

Donacion nga UN-HABITAT për projektin “Përmirësimi i hapësirave publike në fshatin Gorancë dhe Paldenicë në shumë prej 25,503.58 EUR (projekt i vitit 2014).

Donacion nga DEMOS për projektin “Shtrimi me kubëza betoni për fshatin Dimcë dhe Seçishtë si dhe Punimi i murit mbrojtës në fshatin Seçishtë në shumë prej 23,099.98 EUR.

Tabela 8. Pagat dhe rogat

	2015		
	GO	THV	Totali
Përshkrimi	€ '000	€ '000	€ '000
Pagesat			
Pagat neto përmes listës së pagave	1,157,860.78	9,157.90	1,167,018.68
Pagesa për sindikatë	4,287.60	5.97	4,293.57
Tatimi ndaluar në të ardhura personale	64,666.48	314.03	64,980.51
Kontributi pensional-punetori	65,069.55		65,069.55
Kontributi pensional-punëdhënësi	65,069.55		65,069.55
Gjithsej Pagesat	1,356,953.96	9,477.90	1,366,431.86

Tabela 9. Shërbimet komunale

	2015	2014
	GQ+THV	GQ+THV
Përshkrimi	€	€
Rryma	39,307.60	28,062.60
Uji	-	-
Mbeturinat	7,746.00	6,599.00
Shpenzimet telefonike	1,007.36	1,153.52
Pagesa-vendimet gjyqësore	-	103.00
Gjithsej Pagesat	48,060.96	35,918.12

Tabela 10. Subvencione dhe transfere

	2015	2014
	GQ+THV	GQ+THV
Përshkrimi	€	€
Pagesat		
Subvencione për entitetet publike	1,000.00	300.00
Subvencione për entitetet jopublike	6,000.00	1,000.00
Pagesa për përfituesit individual	31,639.60	26,862.97
Pagesat e familjareve të të rënëve në luftë	9,000.00	9,000.00
Pagesa-vendime gjyqësore		
Gjithsej Pagesat	47,639.60	37,162.97

SUBVENCIONE PËR ENTITETE PUBLIKE

Ju është dhënë shoqatës “Miqte e Amerikës” për përkrahjen e shtetit shqipëtar për Kosovën në shumë prej 1,000 Euro.

SUBVENCIONE PËR ENTITETE JOPUBLIKE

Ju është dhënë ndihmë SHKA “Sharri” në shumë prej 1,000.00 €

Ju është dhënë ndihmë Klubit të mundjes “Sharri” në shumë prej 1,000.00 € për marrjen pjesë në lojrat olimpike në Azerbajxhan për përfaqësimin e mundësit tonë në kuadër të Federatës së Kosovës.

Ju është dhënë ndihmë shoqatës Handikos në shumë prej 1,000.00 €

Bashkëfinancim mes Komunës dhe Iniciativës për komunitetin Kosova (IKC) për përkrahjen e grave dhe burrave me qëllim të gjenerimit të të hyrave në qytetin dhe fshatrat e komunës Hani i Elezit në shumë prej 3,000.00 € nga komuna dhe 9,675.00 € nga organizata IKC për projektet:

- grupi i plantacionit me mjedër te grupi i grave përfituese dhe
- modernizimin e pajisjeve për bletari te grupi i bletarëve të komunës Hani i Elezit

PAGESA PËR PËRFITUES INDIVIDUAL

Kemi bërë pagesën e bursave për student në shumë prej 10,000.00 €

Kemi bërë pagesën për lehonat nga 100 €për 140 lindje në shumë prej 14,000.00 €

Kemi ndihmuar fermerët për mbjelljet vjeshtore për grure dhe derivate në shumë prej 6,639.60 € (42 fermerë).

Kemi ndihmuar studentin Femi Ballazhi për vashdimin e studimeve me 500.00 €

Kemi ndihmuar Nusret Pllanën për botimin e librit Terrori i Serbisë me 500.00 €

PAGESAT PËR FAMILJET E TË RËNËVE NË LUFTË

Kanë të bëjnë me pagesat e familjeve të dëshmorëve të rënë në Luftën e Maqedonisë (5-familje nga 150.00€në muaj apo 9,000.00 €për dymbëdhjetë (12) muaj.)

Tabela 11. Investimet kapitale

Përshkrimi	2015	2014
	GQ+THV+D €	GQ+THV+D €
NDËRTESAT E BANIMIT	9,944.00	-
OBJEKTET ARSIMORE	100,000.00	37,000.00
OBJEKTET MEMORIALE	4,997.00	-
NDËRTIMI I RRUGËVE LOKALE	29,295.34	176,629.00
TROTUARET	63,444.86	-
KANALIZIMI	78,753.89	9,684.60
UJËSJELLËSI	4,992.00	79,998.93
PAISJE TE TEKNOLOGJISE INFORMATIVE	-	19,926.00
MOBILJE	6,125.00	7,713.00
PAISJE TJERA	9,892.56	9,970.00
VETURA ZYRTARE	34,000.00	-
KAPITAL TJETER		96,376.65
TOKA-SHPRONËSIM	1,630.00	4,800.00
TRANSFERE KAPITALE-ENTITETE JOPUBLIKE	13,000.00	-
PAGESA-VENDIME GJYQESORE (SHPRONËSIM)	11,594.61	-
Gjithsej Pagesat	367,669.26	442,098.18

Tabela 12. Përmbledhje e Mallrave dhe shërbimeve

Përshkrimi	2015	2014
SHPENZIME PËR UDHËTIME ZYRTARE BRENDA VENDIT (transporti)	6,593.00	7,688.00
SHPENZIME TJERA PËR UDHËTIME ZYRTARE BRENDA VENDIT	979.90	-
MËDITJET PËR UDHËTIME ZYRTARE JASHTË VENDIT	3,683.80	3,962.80
SHPENZIME TJERA PËR UDHËTIME ZYRTARE JASHTË VENDIT	234.00	125.60
A KOMODIMI PËR UDHËTIMET ZYRTARE JASHTË VENDIT	1,605.00	-
SHPENZIMET PËR INTERNET	1,320.00	1,322.36
SHPENZIMET E TELEFONISË MOBILE	7,640.55	7,631.15
SHPENZIMET POSTARE	1,127.98	1,141.12
SHËRBIME TË NDRYSHME SHËNDETSORE	4,475.00	-
SHËRBIME SHTYPJE-JO MARKETING	2,123.00	1,800.00
SHËRBIME KONTRAKTUESE TJERA	22,316.65	20,957.00
SHËRBIME TEKNIKE	2,823.58	245.75
SHPENZIMET PËR ANËTARËSIM	1,440.30	1,440.30
SHËRBIMET E VARRIMIT	3,060.00	-
MOBILJE (ME PAK SE 1000 Euro)	10,907.90	-
KOMPJUTERË ME PAK SE 1000 Euro	3,100.00	950.00
PAISJE TJERA <1000	8,216.40	3,910.95
BLERJA E LIBRA VE DHE VEP. ARTISTIK	755.20	-
FURNIZIME PËR ZYRË	20,864.77	17,435.92
FURNIZIM ME USHQIM & PIJE (JO DREKA ZYRTARE)	5,874.59	3,663.70
FURNIZIME MJEKËSORE	13,951.08	698.80
FURNIZIME PASTRIMI	12,684.14	5,763.99
FURNIZIM ME VESHMBATHJE	270.00	1,795.00
NAFTË PËR NGROHJE	-	2,440.00
QYMYR	1,700.00	-
DRU	18,671.82	6,840.40
DERIVATE PËR GJENERATOR	10.00	56.59
KARBURANT PËR VETURA	26,582.51	15,318.02
PROVIZION BANKAR-NLB BANK	293.50	84.00
REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	6,286.49	4,891.15
MIRËMBAJTJA DHE RIPARIMI I AUTOMJETEVE	20,507.25	10,903.23
MIRËMBAJTJA E NDËRTESA VE	4,418.90	2,728.50
MIRËMBAJTJA E NDËRTESA VE TË BANIMIT	791.00	-
MIRËMBAJTJA E SHKOLLA VE	3,645.61	2,281.90
MIRËMBAJTJA OBJEKTEVE SHENDETËSORE	480.00	100.00
MIRËMBAJTJA E AUTO RRUGËVE - NDRIÇIMI PUBLIK	4,987.60	-
MIRËMBAJTJA AUTO RRUGËVE LOKALE- MIRËMBAJTJA E RRUGËVE	3,200.00	452.00
MIRËMBAJTJA E TEKNOLOGJISE INFORMATIVE	5,008.62	1,547.00
MIRËMBAJTJA E MOBILEVE DHE PAISJEVE	135.56	1,628.00
REKLAMAT DHE KONKURSET	120.00	635.00
BOTIMET E PUBLIKIMEVE	9,805.00	4,345.00
DREKA ZYRTARE	21,212.83	12,724.19
SHPENZIME-VENDIMET E GJYKATA VE	662.00	190.00
Gjithsej Pagesat	264,565.53	147,697.42

Shpjegime në kategorinë mallra dhe shërbime

Shpenzimet e udhëtimit zyrtar brenda vendit- ka të bëjë me shpenzimet e transportit të nxënësve për realicionin Hani i Elezit-Krivenik-anasjelltas dhe Hani i Elezit-Kashan-Uji i Thartë - anasjelltas për periudhën janar-nëntor 2015 në shumë prej 6,593.00 €

Shpenzimet tjera për udhëtimet zyrtare brenda vendit – ka të bëjë me shërbimet e transportit të nxënësve të Hanit të Elezit nëpër Kosovë në shumë prej 979.90 €

Mëditjet e udhëtimit zyrtar jashtë vendit - ka të bëjë me udhëtimet zyrtare që kanë marrë pjesë në Shqipëri, Greqi, Slloveni, Turqi, Kroaci.

Akomodimi për udhëtimet zyrtare jashtë vendit - ka të bëjë me udhëtimin dhe akomodimin në vizitën e Bashkisë së Tiranës në Shqipëri për këshilltarët komunal në shumë prej 1,600.00 €

Shpenzimet për anëtarësim – ka të bëjë me shpenzimet për anëtarësim me Agjencionin për Zhvillim Rajonal Lindje në shumë prej 500.00 € dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës në shumë prej 940.30 €

Pajisje tjera - ka të bëjë me furnizimin me dy inventar për dy shkolla (Shfmu. “Kështjella e Diturisë” dhe Shfmu “Veli Ballazhi”) dhe instalime elektrike për administratë komunale.

Furnizime mjekësore – ka të bëjë me shpenzimet për furnizime mjekësore për shëndetësi, ku është paguar borxh i vitit 2014 në shumë prej 5,822.90 € kurse pjesa tjetër ka të bëjë gjatë këtij viti në shumë prej 8,128.18 €

Mirëmbajtja e auto rrugëve - ndricimi publik - ka të bëjë me shpenzimet për mirëmbajtjen e ndricimit publik nëpër disa lagje të Hanit të Elezit në shumë prej 4,987.60 €

Mirëmbajtja e auto rrugëve lokale - ka të bëjë me mirëmbajtjen e rrugëve dhe vendeve me zhavor që ka pasur vërshime dhe shembje të dheut (në Lagje të re dhe në rrugë të Gorancës).

Botimet e publikimeve - ka të bëjë me material shtypi si: publikimin e kalendarit 2014 të komunës së Hanit të Elezit, kalendarit 2015, kimikë, shkrepsa në shumë prej 8,200.00 € dhe furnizimin me kalendar në gazetën zyrtare Kosova Sot në shumë prej 990.00 € ku borxhe të vitit 2014 kanë qenë në shumë prej 255.00 €, shërbime të publikimeve në gazetën zyrtare Epoka e re dhe Kosova Sot në shumë prej 360.00 €

Dreka zyrtare - ka të bëjë me pije të ndryshme nga Ekzekutivi i komunës dhe Legjislativi (takime me donatorë, trajnime, mbledhje të ndryshme në sallë të kuvendit) në shumë prej 10,549.68 € pastaj dreka zyrtare në shumë prej 3,702.40 € (borxh i vitit 2014), pastaj darkë për 7 Marsin - Dita e Mësuesit në shumë prej 395.00 € (50% komuna+50% sindikata e arsimit), darkë për familjet e dëshmorëve dhe bashkësisë islame në shumë prej 260.00 € darkë për shënimin e Epopesë së UÇK-së në shumë prej 1,161.00 € darkë zyrtare për shënimin e 11 Qershorit – Ditës së çlirimit në shumë prej 2,786.00 € darkë për ditën e 29 gushtit- ditës së dëshmorëve në shumë prej 135.50 € dreka me përfaqësues të ministrive, organizatave, kompanive publike, donatorë të ndryshëm në shumë prej 2,223.25 €

Tabela 13. Lista e projekteve kapitale për vitin 2015

Nr	Programi/përshkrimi	Projektet e realizuara nga:		Total	Emri i Donatorit
		Komuna	Grantet dhe Donacionet	Komuna + Donacionet	
	SHPENZIMET KAPITALE TOTALE	313,715.46	351,630.34	665,345.80	
	Administrata dhe Personeli	34,000.00		34,000.00	
1	Blerja e automjeteve për administratën komunale	34,000.00		34,000.00	
	Shërbimet Publike dhe Emergjencia	24,968.00		24,968.00	
2	Riparimi i rrugëve dhe trotuareve të Hanit të Elezit	9,983.00		9,983.00	
3	Riparimi dhe rregullimi i rrjetit të ujësjellësit të Hanit të Elezit	4,992.00		4,992.00	
4	Fond për emergjencë	9,993.00		9,993.00	
	Planifikim Urban dhe Mjedisi	148,622.46	335,630.34	484,252.80	
5	Ndërtimi dhe rregullimi i prockës në Lagjen e re	58,981.39	70,000.00	128,981.39	MAPL
6	Renovimi dhe Fasadimi i objektit të Komunës	-	193,630.34	193,630.34	Kom. Evropian
7	Bashkëfinancim - Fondacioni Kosovë Luksemburg - Komuna Hani i Elezit me bizneset fillestare dhe ekzistuese (50%+25%+25%)	13,000.00	39,000.00	52,000.00	Fond. Kosovë Luksemburg + Përfituesit
8	Instalimi i nxemjes qendrore në aneksin e QKMF-së	9,892.56		9,892.56	
9	Bashkëfinancim për ndërtimin e tri shtëpive me raste sociale	9,944.00		9,944.00	
10	Shtrimi me kubëza në fshatin Dimcë dhe Seçishtë	12,301.00	28,703.78	41,004.78	DEMOS
11	Punimi i murit mbrojtës në rrugën Foleja e Uçk-së në fshatin Seçishtë	2,540.30	4,296.22	6,836.52	DEMOS
12	Riparimi i Kompleksit të varrezave të dëshmorëve në Pustenik (Ndërtimi i pllakave të lapidarit)	4,997.00		4,997.00	
13	Fond për hartimin e projekteve	3,969.10		3,969.10	
14	Fonde për shpronësim	1,630.00		1,630.00	
15	Rregullimi i Kanalizimeve në lagjet e mbetura të zonës urbane të Hanit të Elezit	9,848.50		9,848.50	
16	Rregullimi i Kanalizimeve në lagjet e mbetura të zonave rurale të Hanit të Elezit (Rezhancë, Paldenicë, Gorancë)	9,924.00		9,924.00	
17	Pagesa - Vendime gjyqësore (Shpronësim)	11,594.61		11,594.61	
	Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale	6,125.00		6,125.00	
18	Pajisje me inventar dhe mobilje për QKMF	6,125.00		6,125.00	
	Arsimi dhe Shkenca	100,000.00	16,000.00	116,000.00	
19	Aneksi i shkollës fillore "Ilaz Thaçi" në Han të Elezit- faza e dytë	100,000.00		100,000.00	
20	Ndërtimi i murit mbrojtës të fusha e sportit në Shfmu. "Kështjella e Diturisë" në Paldenicë		8,000.00	8,000.00	Ambasada Amerikane
21	Paisja me inventar e dy klasave për parashkollor (Shfmu. "Kështjella e Diturisë" në Paldenicë dhe Shfmu. "Veli Ballazhi" në Gorancë)		8,000.00	8,000.00	Karitasi Zviceran

Tabela 14. TË HYRAT VETANAKE PËR VITIN 2015

Nr	Përshkrimi	Planifikimi 2015	Realizimi 2015	Realizimi 2014	Progresi në %	Krahasimi 2015/14 në %
		1	2	3	4=2/1	5=2/3
1	Certifikatat e lindjes	2,950.00	2,908.00	2,935.00	98.58	-0.92
2	Certifikatat e kurorëzimit	750.00	720.00	320.00	96.00	125.00
3	Certifikatat e vdekjes	150.00	252.00	120.00	168.00	110.00
4	Certifikata tjera ofiqarie	2,150.00	1,419.00	2,039.00	66.00	-30.41
5	Taksa administrative	1,248.00	1,125.00	1,067.00	90.14	5.44
I	Administrata e Përgjithshme	7,248.00	6,424.00	6,481.00	88.63	0.89
6	Tatimi në pronë	96,834.00	81,186.93	92,284.99	83.84	-12.03
7	Taksë për regjistrim të automjeteve	14,000.00	14,910.00	13,461.00	106.50	10.76
II	Buxhet dhe Financa	110,834.00	96,096.93	105,745.99	86.70	-9.12
8	Të hyrat nga reklamimet publike	5,000.00	8,440.00	12,786.50	168.80	-33.99
9	Licenca tjera për afarizëm	900.00	845.00	625.00	93.89	35.20
10	Gjobat tjera	150.00	150.00	-	100.00	0.00
III	Shërbimet Publike	6,050.00	9,435.00	13,411.50	155.95	-29.65
11	Të hyrat nga ushtrimi i veprimtar. afariste	85,000.00	71,475.00	74,441.79	84.09	-3.99
12	Licenca për pranim teknik të lokalit	200.00	50.00	345.00	25.00	-85.51
IV	Zhvillimi Ekonomik	85,200.00	71,525.00	74,786.79	83.95	-4.36
13	Taksa komunale për leje ndërtimi	7,000.00	1,261.65	4,916.77	18.02	-74.34
14	Taksë për përcaktimin e hipotekës	4,475.00	2,062.00	4,302.00	46.08	-52.07
15	Ndërrim destinimi i tokës	1,000.00	370.00	23,694.35	37.00	-98.44
16	Shërbime të ndryshme kadastrale	3,951.00	4,699.00	3,709.00	118.93	26.69
17	Shfrytëzimi i pronës publike	7,000.00	7,956.92	8,858.12	113.67	-10.17
18	Të hyrat nga shitja e pasurisë	4,900.00	3,620.00	4,275.20	73.88	-15.33
19	Ndarja e parcelave	2,900.00	2,744.00	2,796.00	94.62	-1.86
V	Urbanizimi dhe Kadastri	31,226.00	22,713.57	52,551.44	72.74	-56.78
20	Participimet në Arsim	100.00	55.00	40.00	55.00	37.50
VI	Arsimi	100.00	55.00	40.00	55.00	37.50
21	Shërbime sociale	200.00	107.50	-	53.75	0.00
22	Certifikata mjekësore	300.00	126.00	270.00	42.00	-53.33
23	Participimet në shëndetësi	4,800.00	6,328.25	6,080.40	131.84	4.08
24	Inspektimi Higjieniko Sanitar	100.00	150.00	295.00	150.00	-49.15
VII	Shëndetësia dhe MS	5,400.00	6,711.75	6,645.40	124.29	1.00
A	TË HYRAT DIREKTE	246,058.00	212,961.25	259,662.12	86.55	-17.99
25	Gjobat në Trafik	10,000.00	10,355.00	17,441.00	103.55	-40.63
26	Të hyrat nga Gjykatat	200.00	205.00	130.00	102.50	57.69
B	TË HYRAT INDIREKTE	10,200.00	10,560.00	17,571.00	103.53	-39.90
	TOTALI I PËRGJITHSHËM (A + B)	256,258.00	223,521.25	277,233.12	87.23	-19.37

Planifikimi i të hyrave vetanake për vitin 2015 është në shumë prej 256,258.00€
Komuna e Hanit të Elezit ka arkëtuar gjithsej 223,521.25 €të hyra vetanake për periudhën janar-
dhjetor 2015 apo 87.23%.

Të hyrat vetanake të vitit 2015 janë më të ulta për -53,711.87 €apo -19.37%.

Tabela15. Shpalosja e detyrimeve (Faturat e papaguara deri me 31dhjetor 2015)

Përshkrimi	€
Shpenzime te udhëtimit brenda vendit	704.00
Mëditjet e udhëtimit jashtë vendit	125.40
Shpenzimet e telefonisë mobile -vala	366.72
Furnizime për zyre	24.00
Furnizime pastrimi	88.85
Furnizime për ushqim dhe pije	1,400.00
Karburante për vetura	1,512.05
Mirëmbajtja e veturave	146.96
Reklama dhe konkurse	80.00
Drekat zyrtare	3,003.70
Rryma elektrike	9,351.19
Mbeturinat	636.00
Shpenzime e telefonisë fikse	249.64
Pagesat për përfitues individual	2,100.00
Trotuaret	9,900.00
Gjithsejtë	29,688.51

Data: 04.02.2015

Drejtore për Buxhet dhe Financa
Shabi Rexhallari

Kryetari i Komunës
Rufki Suma